



BANKING AND PAYMENTS AUTHORITY OF KOSOVO
AUTORITETI BANKAR DHE I PAGESAVE I KOSOVËS
BANKARSKI I PLATNI AUTORITET KOSOVA

Sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2005/20, mbi Pensionet në Kosovë, të datës së 29 Prill 2005, mbi ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 të datës 22 Dhjetor 2001,

Me qëllim të ekzekutimit të Nenit 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 (“Rregullorja e Pensionit”) në mënyrë që të parashkruhet forma dhe mënyra e pagesave efektive të pensioneve për pjesmarrësit (të pensionuarit dhe përfituesit) të pensioneve të kursyera të siguruara nga Trusti i Kursimit të Pensioneve të Kosovës.

Bordi i Drejtues i Autoritetit Bankar të Pagesave të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 Mars 2006 miraton si vijon:

Rregulla 11 mbi Ndryshimin e Rregullës mbi Pagesën e Pensioneve Individuale të Kursyera të dates 25 Korrik 2002

Neni 1

Sfera dhe qëllimi I Rregullës

1.1 Sfera e Rregullës

Kjo Rregull i adresohet Trustit të Pensioneve të Kursimit të Kosovës (“Trusti”), në kryerjen e pagesave të pensioneve për pjesmarrësit (të pensionuarit dhe përfituesit) e pensioneve individuale të kursimit të siguruara nga Trusti.

1.2 Qëllimi I Rregullës

Kjo rregull parashkruan direktivat për pagesën e pensioneve për pjesmarrësit e pensioneve individuale të kursimit sipas dispozitave të Nenit 13 të Rregullores së Pensionit. Poashtu kjo Rregull themelon direktivat e caktuara në formë dhe lloj të kontratave të anuitetit që do të shfrytëzohen për pagesat e benefiteve të pensioneve dhe formave tjera të pagesave, duke përfshirë shumat totale dhe pagesat fazore para se të jenë në dispozicion kontratat e anuitetit në Kosovë.

Neni 2

Dispozitat e përgjithshme

2.1 Definimi

Të gjitha termet e shfrytzuara në këtë Rregull janë ashtu siq janë definuar dhe caktuar në Rregulloren e Pensionit dhe/ose siq definojnë më pas në këtë Rregull.

“Anuiteti” ose “pagesa e anuitetit” I referohet shumës së vlerës fikse apo të determinueshme të parave (pensioneve) të bëra nga kompania e sigurimit jetsor sipas termeve të kontratës(ve) së tij të anuitetit.

“Anuitanti” është individi në jetën e të cilit është bërë pagesa e anuitetit, është kalkuluar dhe përcaktuar. Në jetën e bashkuar të anuitetit të atij që mbetet gjallë, termi “anuitant” përfshin të gjithë individët e emruar si annuitant në kontratën e anuitetit për të mbuluar ata individ që vdesin të fundit (pas bashkshortit apo bashkshortes).

“Kontrata e anuitetit” I referohet marrveshjes, kontratës ose produktit prej ku kompania e sigurimit jetsor garanton të bëjë disa shuma të determinuara ose fikse të pagesave të rregullta për anuitantin, ose aty ku aplikohet, për përfituesin e tij apo të asaj; perioda e pagesës është e determinuar ose fikse.

“Përfituesi” është personi ose personat e caktuar nga pjesmarrësi ose anutanti(et) për të cilët pagesa e atij/asaj e llogarisë së pensionit individual të kursimit duhet të bëhet. E drejta e përfituesit që të marr pagesat e benefiteve vjen në shprehje nëse pjesmarrësi vdes para fillimit të pensionit të tij; ose nëse vdekja paraqitet te anuitanti(et) para marrjes së të gjitha anuiteteve të garantuara, nëatë masë të pagesave të tilla të garantuara të papaguara të anuitetit.

“Pensioni invalidor” I referohet të drejtës për tu filluar beneficionet e pensionit para moshës 65 vjeqare për pjesmarrësin të cilit I është caktuar invaliditeti I definuar në Ligjin mbi Pensionin Invalidor që I jep asaj/atoj të drejtën për pension invalidor.

“Anuiteti mujor I menjëhershëm” I referohet një anuitetit që paguan pagesa mujore të anuitetit (pensionet) që fillojnë brenda periodës prej 30 ditësh prej datës së kontratës së anuitetit.

“Jeta e bashkuar ose anuiteti për ate që mbetet gjallë” I referohet një kontrate të anuitetit ku janë dy ose më shumë annuitant.

“Perioda e caktuar” nënkupton periodën e specifikuar, fikse të garantuat për pagesën e anuitetit.

“Pagesat fazore” I referohen pagesave vjetore të shumave që janë në një Llogari Individuale nëpërmes të kontratës bankare ose rregullimi tjetër të aprovuar nga BPK-ja.

“Opcionet e setëlmentit” I referohen dispozitave të veqanta në një kontratë të anuitetit që përshkruan opcionet alternative për zgjedhjen e formës dhe mënyrës me të cilën pagesat e anuitetit janë bërë, llogaritur dhe determinuar.

“Anuiteti i jetës së vetmuar” i referohet asaj kontrate të anuitetit ku është vetëm një annuitant.

“Trust” nënkupton Trustin e Pensioneve të Kursimit të Kosovës.

Neni 3

Pagesa e pensionit mujor e siguruar nga Trusti

3.1 Dispozitat e përgjithshme

- a) Fillimi I pagesave të pensioneve. Pagesa e Pensioneve duhet të filloj kur pjesmarrësi arrin moshën e pensionit (moshën 65 vjeqare) ose, më herët kur ai/ajo e vuan kualifikimin e pa aftësis që e bënë ate/atë të pranueshëm për pension invalidor.
- b) Blerja e kontratës së anuitetit. Trusti duhet të shfrytzoj bilancin e llogarive individuale të pjesmarrësve që të blejnë anuitet të menjëhershëm mujor prej kompanis së sigurimit jetsor të autorizuar dhe licensuar nga BPK-ja që të siguroj anuitetet. Pagesa e pensioneve mujore për pensionistët e përfituesit(ve) të atij/asaj duhet të bëhet sipas termeve të kontratës së anuiteit.
- c) Liria e zgjedhjes së kompanisë së sigurimit. Nëse janë disa sigurues të licensuar të anuitetit të aprovuar nga BPK-ja për sigurimin e Pensioneve Individuale të Kursyera, pjesmarrësi do të jetë I lirë që të zgjedh njëren prej kompanive të sigurimit jetsor që sigurojnë anuitet me të cilën ai/ajo kontraktin për anuitet. Trusti do të paguaj ose transferoj bilancin e llogarisë individuale të pjesmarrësve në kompanin e zgjedhur të sigurimit për të blerë anuitetin për pagesën e pensionit të pjesmarrësit.
- d) Siguruesi I vetëm I anuitetit. Nëse nuk ka sigurues të anuitetit në Kosovë,Trusti,me aprovimin e BPK-s,mundë të zgjedh një apo shumë Sigurues të të anuitetit të licensuar në shtetet e duke shfrytëzuar kohë të mjaftueshme për të analizuar me kujdes zgjedhjen e këtij Siguruesi ,për të siguruar praktikat më të mira ndërkombëtare dhe vlerësimin.
- e) Njohtimi për pensionin në dispozicion. Trusti duhet të njohtoj , me shkrim pjesmarrësin për pranimin e atij/asaj që të filloj me pension. Njohtimi duhet të bëhet brenda një viti , mirpo jo më gjatë se gjashtë muaj, para ditlindjes së 65 të pjesmarrësit. Në rastë të pensionit invalidor, pjesmarrësi duhet të njohtoj Trustin për kualifikimin e invaliditetit.
- f) Pagesa e pensionit ndryshe nga ajo nëpërmes të anuitetit. Trusti mund të përshtat rregullat që të kryej pagesat e benefiteve të pensionit ndryshe nga blerja e kontratës së anuitetit në rastet kur:
 - 1.Nëse vlera në llogarinë Individuale të pjesmarrësit është 2,000 Euro ose më pak,Trusti mundë të paguan shumën totale.
 - 2.Nëse vlera në Llogaritë Individuale të pjesmarrësve është më shumë se 2,000 Euro mirpo më pak se 15,000 Euros, Trusti mundë të negocioj rregullimin e pagesave fazore,duke ju paguar pjesmarrësve jo më pak se 500 €për një anuitet, për bilancin e llogarisë. Trusti duhet të paraqes rregullimin e propozuar për aprovim në BPK 60 ditë para implementimit,duke përfshirë kontratën për pagesa fazore që pasqyrojnë të gjitha normat e fituara të kamatës dhe ndalesat administrative.
 - 3.Trusti mundë të propozojë një prag më të lartë të vlerës se 15,000 për

pagesat e anuitetit ,për aprovim në BPK,duke paraqitur arsyetimin ekonomik.

4. Nëse I është bërë pagesa përfituesit ose përfituesve të pjesmarrësit I cili ka vdekur para moshës 65 vjeqare ose para arritjes në planin e pagesave fazore ose të kontratës efektive të anuitetit për pagesën e pensionit të asaj/atij,qdo shumë që qëndron në llogaritë Individuale mundë të transferohet në llogarinë individuale të Përfituesit,nëse kështu zgjedh përfituesi. Shuma që është në Llogarinë Individuale gjithashtu mundë të paguhet si shumë totale nëse është nën 2,000 Euro dhe 15,000 Euro,nëse përfituesi e zgjedh këtë mundësi.

5. Nëse pjesmarrësi që është duke pranuar pagesa fazore vdes para pranimit së vlerës që gjendet në Llogarinë Individuale,pagesat e mbetura fazore do ti paguhen përfituesit.

Neni 4

Kontrata e anuitetit e shfrytzuar për pagesën e pensioneve

4.1 Forma dhe lloji I kontratës së anuitetit

Kontrata e anuitetit që do të shfrytzohe për pagesën e pensionit duhet të jete një Anuitet Mujor I Menjëhershëm që ofron optionet si vijojnë të setëlmentit:

a)Anuiteti I jetës së vetmuar. Pagesa mujore e anuitetit (pensionet) bëhen deri në vdekje të anuitantit të emruar. Pagesat e tilla janë llogaritur dhe determinuar në metodat statistikore të jetgjatsisë të jetës së anuitantit.

b)Jeta e bashkuar ose anuiteti për atë që mbetet gjallë. Janë dy ose më shumë anuitant. Pagesat mujore te pensionit bëhen deri në vdekjen e anuitantit të fundit. Pagesat e tilla janë llogaritur dhe determinuar duke u bazuar në metodat statistikore të jetgjatsisë të anuitantit të emruar I cili pritet që të jetoj më se gjati prej anuitantëve të emruar.

c)Perioda e caktuar. Pagesat e anuitetit janë të garantuara për numrin fiks të viteve ose të muajve.Llogaritja dhe determinimi I pagesave të anuitetit nuk varet në jetgjatsinë e pritur të jetës së anuitantit. Kjo bazohet vetëm në gjatsinë e periodës së specifikuar për të cilën duhet të bëhen pagesat e rregullta mujore të anuitetit.Nëse anuitanti vdes gjatë periudhës së caktuar, pagesat e garantuara të papaguara I paguhen përfituesit(ve) të emruar.

d)Jeta e vetmuar me periodë të caktuar.Pagesat mujore të pensionit janë garantuar për periodën e specifikuar (periodë të caktuar) dhe, nëse anuitanti jeton më gjatë se ajo periodë, pagesat mujore të pensionit vazhdojnë deri në vdekje të atij/asaj. Nëse anuitanti vdes gjatë asaj periode të caktuar, përfituesi I atij/asaj pranon pagesat e garantuar të mbetura të pensionit.

e)Jeta e bashkuar/ai që jeton më gjatë me periodë të caktuar. Pagesat mujore të pensionit janë garantuar për periodë të specifikuar (periodë të caktuar) dhe , nëse pas përfundimit të asaj periode të caktuar, ndonjeri prej anuitantëve të bashkuar është ende gjallë, pagesat mujore të pensionit vazhdojnë deri në vdekje të anuitantit të fundit. Nëse në qfardo kohe gjatë asaj periode të caktuar asnjeri prej anuitantëve nuk mbetet gjallë, pagesat e pensioneve të garantuara të pa paguara I paguhen përfituesit të emruar.

4.2 Kushtet dhe kufizimet e aplikueshme për kontrata e anuitetit të pensionit

a)E drejta e pjesmarrësit që të zgjedh optionin e setelmentit varet nga kushtet si vijojnë:

1)Pjesmarrësi I cili në fillim të pensionit të atij/asaj, ka bashkshortin me të cilin është martuar në periodën së paku një vit para arritjes së moshës së pensionit (ose pension invalidor) mundë të zgjedhë vetëm opcionin e setëlmentit që është ose:

(i)Jetë e bashkuar dhe anuitet për ate që jeton edhe më, ose

(ii)Jetë e bashkuar dhe I atij që mbijeton me anuitet me periodë të caktuar, me bashkshortin/bashkshorten si annuitant I bashkuar.

2.Opcioni I setëlmentit i periodës së caktuar, pa elementin e jetës, nuk mund të jetë më e shkurtër se (5) pesë vite dhe është në dispozicion vetëm si opcion setelmenti për pagesën e pensionit nëse shuma e pensionit mujor, që aplikon opcionin e anuitetit të jetës së vetmuar është më e vogël se shuma që është paguar si Pension Bazik në Kosovë në vitin kur pjesmarrësi e arrin Moshën e Pensionit.

3.Një opcion efektiv I setelmentit, I bërë njëherë dhe I implementuar, ndoshta nuk do të ndryshohet.

b)Departamenti I Sigurimit në BPK mundë të përshkruaj Rregullat e Sigurimit të aplikueshme për kompanitë e sigurimit të autorizuara që të sigurojnë kontrata anuiteti për pagesën e pensionit dhe për produkte të tilla të anuitetit.Rregullat e tilla do të jenë në pajtim me kërkesat e Rregullores së Pensionit dhe këtë Rregull dhe ata duhet të përfshijnë minimumin e kushteve/kërkesave:

1).E aplikueshme për kompanitë e sigurimit:

(i)Duhet të jetë kompani jetsore e sigurimit.

(ii)Duhet të ketë dhe të mbaj një “Departament të Anuitetit” me staf adekuat me oficerë dhe nëpunësa që janë të kualifikuar si duhet që të administrojnë anuitetet dhe pensionet.

(iii)Duhet ti sigurojnë anuitantit një kopje të vlerës së asaj/atij të llogarisë së anuitetit së paku në intervalin prej 12 muajsh, dhe me së paku dy ekstrakte të përkohshme gratis për vit kur ato kërkohen nga anuitanti.

(iv)Duhet të segregojë, në të gjitha kohët, biznesin dhe produktet e mjeteve themelore të anuitetit për pagesat e pensioneve prej të gjitha mjeteve tjera që I takojnë sigurimit jetsor të tij dhe bizneseve tjera të anuitetit.

(v)Duhet të mbaj shërbim të një staticienti të njohur nga BPK që të vërtetoj dhe bëjë vlersimin e produkteve të anuitetit të shfrytzuar për të paguar pensionet.

(vi)Duhet të ketë dhe mbaj “minimum solvency margin” prej më së paku 125%.

(vii)Duhet të siguroj kontratën e anuitetit për pagesën e pensioneve për të gjithë individët e pranueshëm të pensionit në pajtim me shkallën e tij të publikuar dhe dispozitat e kontratës së anuitetit në pajtim me Rregulloren e Pensionit dhe Rregullat e BPK-s.

(viii)Të mos kompenzoj ose dhuroj në mënyrë direkte apo indirekte benefite kolaterale për pensionerët potencial, ose Trustin, Punëdhënësin ose personat e bashkuar të Pundhënësit si një nxitje ose shpërblim për personat e tillë në blerjen e produktit të tij të anuitetit.

(2)E aplikueshme për kontratat e anuitetit:

(i)Shkallët e anuitetit (pagesat e pensionit) duhet të llogariten, determinohen dhe publikohen duke u bazuar në kombinimin e faktorëve si vijojnë:

a)Moshën e anuitantit; ose anuitantët në rast të jetës së bashkuar të anuitetit të atij që jeton edhe më.

b)Perioda e caktuar për pagesat e garantuara.

c)Shkalla e garantuar e interesit, jo më e vogël se 3% për vit.

d)Shuma e siguruar si pjesmarrje e profitit e mbajtësve të anuitetit në pajtim me parametrat e parashkuara nga BPK-ja në Rregullat e saj të Sigurimit.

e)Shuma e fondeve në llogaritë individuale të pjesmarrësit që shfrytëzohet për të blerë anuitetin.

(ii)Shkalla e anuitetit duhet të jetë uniforme për të gjithë individët dhe nuk duhet të ketë diskriminime në baza të shëndetit, gjinisë, racës, religjionit, nacionalitetit, ose tjera kritere të ngjashme të anuitantit(ve) ose përfituesit(ve).

(iii)Pagesat e anuitetit duhet të bëhen në baza mujore, e cila e para nuk duhet të jetë më vonë se 30 ditë prej datës efektive të kontratës së anuitetit.

(iv)Dispozitat që specifikojnë kohën dhe mënyrën në të cilën kompania e sigurimit fiton ose kërkon qertifikatën prej anuitantit (ose përfituesit(ve) që pranojnë pensionet është (janë) gjallë, sigurimi se dështimi I anuitantit ose përfituesit që të dorzojë qertifikatën ose dëshmi tjera që ai/ajo është gjallë, nuk I jep të drejtë kompanisë së sigurimit që të ndal pagesën e pensionit.Pagesa e pavend ndaj anuitantit të vdekur ose përfituesit është përgjegjësi e Kompanisë së Sigurimit.

(v)Shuma e tatimeve dhe taksave, të cilat nuk duhet të jenë më të larta se qmimi I arsyeshëm aktual, që kompania e sigurimit mund ti ngarkoj në relacion me dërgimin e pensioneve (pagesat e anuitetit) për ata që jetojnë jashtë, dhënja e ekstraktit të llogarisë dhe/ose informatat që janë kërkuar nga anuitanti (përfituesi) ndryshe nga ato për të cilat kompania e sigurimit është e obliguar që ti shërbej gratis, në pajtim me termet e kontratës së tij të anuitetit, Rregulloret dhe këto Rregulla.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Kjo rregull si e ndryshuar do të hyj në fuqi më 01 Prill 2006.

Michel Svetcine

Drejtori i përgjithshëm